



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202301145/6

Tiranë ___/___/2024

Lënda: Rekomandim për garantimin e sigurisë në shkollën 9-vjeçare Velabisht

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

TIRANË

BASHKISË BERAT

BERAT

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), është vënë në lëvizje nëpërmjet prindërve të nxënësve të shkollës 9-vjeçare Velabisht, të cilët në ankesën me datë 7.12.2023, kanë shprehur shqetësimin lidhur me mungesën e rojes në këtë shkollë.

Bazuar në pikën 1, të nenit 60, të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, (ligji nr.8454/1999) AP-ja kreu hetimin administrativ duke kërkuar informacion zyrtar nga Bashkia Berat dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave mbi këtë çështje.

Sipas nenit 3/3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) "Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në **fushën e sigurisë**, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur."

Në përgjigje të shkresës së AP-së me nr. K5/S8-2 prot. datë 13.12.2023, “Kthim përgjigje”, Bashkia Berat ka sqaruar si më poshtë vijon:

“Bashkia Berat, në kuadër të legjislacionit në fuqi, që rregullon marrëdhëniet në fushën e arsimit dhe të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve shqiptar, ka patur në fokusin e saj krijimin e kushteve sa më optimale për nxënësit e shkollave, duke përfshirë dhe shkollat 9-vjeçare. Theksojmë se Bashkia Berat në shkollën 9-vjeçare Velabisht ka investuar, duke krijuar një kënd sportiv, në ndihmë të realizimit të procesit mësimor, si dhe për t’u përdorur nga nxënësit edhe për aktivitete të tjera sportive jashtë kohës mësimore. Bashkia Berat në shkollën Velabisht ka implementuar panele diellore, duke siguruar ngrohjen e ambienteve të kësaj shkolle dhe duke i’u ofruar nxënësve një ambient sa më të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor.

Ju informojmë se, sipas përcaktimeve ligjore dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe duke i gërshetuar me buxhetin aktual të bashkisë është ndjekur një politikë e vendosjes së një roje për shkollat në të cilat numri i nxënësve që frekuentojnë ato është më e madh se 100 nxënës. Aktualisht, në 28 shkolla të Bashkisë Berat ekziston një vendpune roje.

Duke qenë se shkolla 9-vjeçare Velabisht ka qenë në limitet e kësaj shifre (mbi ose nën), ka mbetur pa një vendpune të përcaktuar roje në të. Kjo situatë ekziston edhe në disa shkolla të tjera në territorin e Bashkisë Berat, ku numri i frekuentimit është në kufijtë e 100 nxënësve.”¹

Në Bashkinë Berat janë gjithësej 39 institucione të edukimit nga të cilat 31 shkolla 9-vjeçare dhe 8 shkolla të mesme të përgjithshme dhe të bashkuara, ku në 28 shkolla ekziston një vendpune roje.

Bazuar në informacionin zyrtar të Bashkisë Berat, AP-ja nëpërmjet shkresës zyrtare nr.K5/S8-4 prot., datë 19.01.2024, kërkoi informacion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit,(MAS) të cilët kanë sqaruar si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës suaj me nr.K5/S8-4 prot. datë 19.01.2024, lidhur me kërkesën për dërgimin e një kopjeje të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që përcakton punësimin e rojeve të shkollës bazuar në numrin e nxënësve, ju informojmë se bazuar në nenin 28, të ligjit

¹ Shkresa zyrtare me nr.6382/1 datë 03.01.2024 të Bashkisë Berat

69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik është kompetencë e njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore².”

Bazuar në informacionin e MAS-it dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, AP-ja konstaton se nuk ka një standard të vendosur për punësimin e rojeve të shkollës bazuar në numrin e nxënësve. Pra, referuar shkronjës “c”, të nenit 28 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar³, ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik është detyrë e Bashkisë Berat. Gjithashtu, MAS-I, bazuar në pikën 8, të kreut XXV të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”, i ka kaluar Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore kompetencat për emërimin dhe largimin nga puna të punonjësve të shërbimit mbështetës (sanitar/roje) që shërbejnë në institucionet e arsimit parauniversitar⁴.

AP-ja sjell në vëmendje të MAS-it që nuk mund të qendrojë indiferente nëpërmjet delegimit të përgjegjësisë por duhet të verifikojë si realizohen parashikimet në ligj që institucionet e edukimit të jenë mjedise të sigurta në kuadër të politikave për arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor.

Për sa më sipër, referuar informacionit zyrtar të Bashkisë Berat sipas të cilit punësimi i rojes bazohet në ndjekjen e një politike/udhëzimi që e lidh këtë punësim me numrin e nxënësve në institucionin arsimor (mbi 100 nxënës), me keqardhje AP-ja konstaton se kjo nismë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore të sipërcituar. AP-ja është në dijeni të faktit që vendin tonë nuk ekziston ende një formulë për përcaktimin e fondeve pranë Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar. Një pjesë e fondeve qendrore, që njihen si transferta të pakushtëzuara, përlllogariten bazuar në formulën ‘për nxënës’ të krijuar në vitin 2002, por këto nuk ofrojnë fonde diferenciale bazuar në nevojat e nxënësve. Këto transferta, iu përgjigjen nevojave të popullsisë, bazuar në të dhëna, si numri i nxënësve ose të ardhurat mesatare të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore.

² Shkresa zyrtare me nr.635/1 datë 06.02.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

³ Gërma “c”, e pikës 2, të nenit 28 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar parashikon se “... Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë: c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik...”;

⁴ Pika 8, e kreut XXV të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH” parashikon se “...Punonjësit e shërbimeve mbështetëse punësohen dhe largohen nga puna nga NJVV-të...”

Në këtë kuptim, shqetësimi ynë institucional shkon në drejtim të ruajtjes dhe sigurisë së nxënësve në mjediset e shkollës, të cilat duhet të garantohen në çdo rast dhe në çdo shkollë. Ky shqetësim është i qensishëm bazuar në problematikat e identifikuara dhe të bëra publike kohët e fundit si dhe në studimin “*Sjellja shëndetësore tek fëmijët e moshës shkollore*” (HBSC), botuar më 27 mars 2024, nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, (OBSH) në të cilën raportohet se “...*Shqipëria renditet në vendin e katërt, në listën e vendeve me përplasjet fizike më të shumta në numër, që kryesisht nisin në mjediset e institucioneve të edukimit dhe rrjetet sociale. Një në 10 adoleshentë raportoi se ishte përfshirë në përleshje fizike të paktën tre herë në 12 muajt e fundit (14% e djemve dhe 6% e vajzave).* Dhuna mes bashkëmoshatarëve është një sjellje e përhapur në mesin e fëmijëve të moshës shkollore dhe ka efekte negative në mirëqenien e tyre.

Gjithashtu, për nga natyra komplekse dhe delikate e këtij lloj shërbimi, autoritetet shtetërore përgjegjëse duhet të jenë tepër rigorozë dhe të kujdesshëm kur kontraktojnë shërbime të tilla, pasi në këtë rast, interesi më i lartë i fëmijës duhet të mbizotërojë.

Shkolla është një institucion edukimi që duhet të garantojë siguri dhe kjo siguri të mos jetë vetëm brenda hapësirës së shkollës dhe vetëm brenda oborrit, por të jetë brenda një dimensionit të sigurie që ne e kemi quajtur “Perimetri i sigurisë në shkolla”. Nuk duhet të harrojmë se brenda shkollës mund të ndodhin një sërë fenomenesh si, akte dhune, vandalizimi, dëmtime të mjediseve, shkarravitje muresh apo hyrje në shkollë të personave të paautorizuar. Qëllimi i sigurisë në shkolla është pikërisht mbrojtja nga pasojat negative të këtyre fenomeneve. Shkolla duhet të jetë një vend i sigurt për të gjithë fëmijët si në aspektin fizik ashtu edhe në atë psikologjik.

Për sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, në interesin më të lartë të tyre në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit dhe, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999, institucioni i Avokati i Popullit,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave të menjëhershme, nga Bashkia Berat për punësimin e rojes në shkollën 9 vjeçare Velabisht, për funksionimin normal të procesit të edukimit dhe për të garantuar

një mjedis të sigurt në institucionin arsimor mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës.

- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për realizimin e një vlerësimi në rang kombëtar në institucionet e edukimit, të cilat nuk kanë kushtet minimale të sigurisë nëpërmjet punësimit të rojeve në shkollë për të bërë të mundur hartimin e politikave përgjithësuese për të adresuar këtë problem në nivel kombëtar.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454/1999 organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi!

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ